

1.

a) Përcaktoni shkaku e formimit të erërave.

1 pikë

Ndryshimi i trysnisë atmosferike në drejtim horizontal nga një vend në një vend tjetër.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton shkaku e formimit të erërave.**

b) Përcaktoni elementet e erës dhe faktorët që ndikojnë në të dy elementët e saj.

7 pikë

Elementet e erës janë: drejtimi dhe shpejtësia

*Tek drejtimi ndikojnë:*

- Ndryshimi i trysnisë midis dy masave të ajrit
- Forca shmangëse e rrotullimit të Tokës
- Forca e fërkimit.

*Tek shpejtësia e erës ndikojnë:*

- Sa më i madh të jetë ndryshimi i trysnisë, aq më e madhe do të jetë shpejtësia e erës
- Forca e fërkimit.

**Nxënësi fiton:**

**7 pikë nëse përcakton dy elementët e erës, tre faktorët e drejtimit dhe dy faktorët e shpejtësisë**

c) Emërtoni figurën e mëposhtme. Çfarë përcaktohet nëpërmjet saj?

2 pikë


Figura paraqet trëndafilin e erërave, në bazë të të cilës përcaktohet drejtimi dhe madhësia nga fryn era.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse emërton figurën**

**1 pikë nëse shkruan se çfarë përcaktohet nëpërmjet saj.**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**



2. Këndi i rënies së rrezeve të Diellit në Tokë në orën 12.00 është më i madh, ndërsa në orën 14.00 është më i vogël.

a) Në ç'orë temperaturat e ajrit në Tokë janë më të mëdha?

1 pikë

**Përgjigje:**

Temperatura e ajrit në Tokë është më e lartë në orën 14.00 dhe jo në orën 12.00, pavarësisht se këndi i rënies së rrezeve të Diellit është më i madh në orën 12.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton se temperatura e ajrit është më e lartë në orën 14.00**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

b) Argumentoni përgjigjen tuaj.

3 pikë

Kjo ndodh pasi temperaturat e ajrit në Tokë ngrohen më tepër nga rrezatimi tokësor, sesa nga rrezatimi diellor. Deri në orën 12.00 toka merr vazhdimisht nxehtësi nga dielli, dhe më pas e lëshon nxehtësinë në ajër. Për këtë arsye, temperatura e ajrit është më e lartë në orën 14.00 sesa në orën 12.00.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse bën shpjegimin e saktë**

**2 pikë** nëse shkruan faktin që toka ngrohet më shumë nga rrezatimi tokësor dhe më pas e lëshon rrezatimin në ajër

**1 pikë** nëse shkruan vetëm që toka ngrohet më shumë nga rrezatimi tokësor.

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

3. Vëzhgoni me kujdes hartën.

a) Shpërndarjen e cilave dukurive natyrore tregon kjo hartë? **2 pikë**

Harta tregon shpërndarjen e tërmeteve dhe vullkaneve

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse shkruan tërmetet dhe vullkanet

**1 pikë** nëse shkruan tërmetet OSE vullkanet

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

b) Shkruani katër zonat/brezat ku kjo dukuri është më e përhapur. **4 pikë**

- Brezi ose zona e Paqësorit (unaza e Zjarrtë e Paqësorit) ku ndodhin 80% e tyre

- Brezi i Mesdheut

- Brezi i Afrikës Lindore

- Mesoret oqeanike (të oqeanit Atlantik, Paqësor dhe Indian).

**Nxënësi fiton:**


**4 pikë** nëse shkruan të katër zonat

**3 pikë** nëse shkruan tre nga zonat

**2 pikë** nëse shkruan dy nga zonat

**1 pikë** nëse shkruan një nga zonat

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare



c) Pse kjo dukuri është përqendruar pikërisht në këto zona. **2 pikë**

**Përgjigje:**

Sepse në ato zona pllakat tektonike ndahen mes tyre me sisteme çarjesh. Në buzët e pllakave tektonike zhvillohet i gjithë aktiviteti tektonik (lindin tërmetet, formohen vullkanet, malet etj.)

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse shpjegon saktë sa më sipër

**1 pikë** nëse shkruan sistemet e çarjeve OSE aktivitetin tektonik në buzët e pllakave

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

4. Lëvizjet e pllakave tektonike formojnë tipa të ndryshëm kufijsh midis tyre.

a) Përcaktoni llojin e kufijve në figurën 1 dhe figurën 2. **2 pikë**

**Përgjigje:**

Figura 1: - kufij divergjentë


Figura 2: - kufij konvergjentë

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë** nëse përcakton të dy tipet e kufijve

**1 pikë** nëse përcakton njërin prej tyre

**0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare



b) Shpjegoni se çfarë ndodh në figurën 1. **4 pikë**

**Përgjigje:**

Figura 1 tregon kur dy pllaka largohen nga njëra – tjetra. Gjatë largimit nga njëra – tjetra të të dyja pllakave, krijohet mes tyre një e çarë e thellë e quajtur rift. Në të çarën e krijuar, del në sipërfaqe të tokës, magma që vjen nga astenosfera. Kjo magmë depozitohet në të dyja anët e riftit dhe formon në oqeanë koren mesoqeanike

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë nëse për shpjegimin e saktë sa më sipër**

**3 pikë nëse shkruan se pllakat largohen nga njëra tjetra, gjatë largimi krijohet një e çarë dhe se nga e çara del magma**

**2 pikë nëse shkruan se pllakat largohen nga njëra tjetra, gjatë largimi krijohet një e çarë**

**1 pikë nëse shkruan se pllakat largohen nga njëra - tjetra**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

- c) Formimin e cilës pjese të rruzullit tokësor shpjegon kjo teori. Shpjegojnë se si janë formuar oqeanet.

**1 pikë**

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse shkruan se janë formuar oqeanet.**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

5.

A klasifikohet qymyri si mineral?

**1 pikë**

**Përgjigje:**

Jo qymyri nuk klasifikohet si mineral.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse shkruan që qymyri nuk klasifikohet si mineral.**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

Argumentoni përgjigjen tuaj.

**2 pikë**

**Përgjigje:**

Në bazë të përkufizimit mineral quhet çdo substancë që formohet nga burime inorganike. Qymyri është formuar nga mbetje organike të bimëve pra jo nga materiale inorganike. Për këtë arsye qymyrguri klasifikohet si shkëmb sedimentar organogjen por jo si mineral.

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë nëse shkruan përkufizimin se ç'quhet mineral dhe se si është formuar qymyri**

**1 pikë nëse shkruan vetëm se qymyri përbëhet nga materiale organike**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

6. Për t'iu përgjigjur pyetjes, bazohuni te figura e mëposhtme.

- a) Cila nga shkronjat përfaqëson pjesën e lumit që gërryhet më shumë?

**1 pikë**

**Përgjigje:**

**Pjesa e lumit që gërryhet më shumë e tregon pjesa B.**


**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton shkronjën B**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

- b) Cila nga shkronjat përfaqëson pjesën e lumit në të cilën depozitohet më shumë?

**1 pikë**



**Përgjigje:**

Pjesa e lumit në të cilën depozitohet më shumë e tregon pjesa C.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton shkronjën C**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

- c) Argumentoni përgjigjen tuaj në të dyja rastet.

**4 pikë**

**Përgjigje:**

Shkronja e cila tregon pjesën e lumit që gërryhet është B pasi lumi në pjesën konkave (të lugët) të kthesës (meandreve) gërryen më shumë pasi shpejtësia e lumit është më e madhe në anën konkave (e lugët) të luginës dhe më e vogël në anën e mysët të saj.

Pra në anën konkave (të lugët) të luginës ndodh gërryerja, ndërsa në anën konvekse (të mysët) ndodh procesi i grumbullimit. Këtu ndikon sigurisht edhe përbërja shkëmbore e luginës.

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë nëse bën shpjegimin e saktë sa më sipër**

**3 pikë nëse bën shpjegimin e plotë të pjesës që gërryhet dhe shpjegimin e pjesshëm të pjesë ku depozitohet ose e kundërta**

**2 pikë nëse bën shpjegimin e plotë të njërës prej tyre**

**1 pikë nëse bën shpjegimin e pjesshëm të njërës prej tyre**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

7. Lumenjtë formojnë tipe të ndryshme grykëderdhjesh.

- a) Identifikoni tipin e grykëderdhjes së lumit në figurën e mëposhtme.

**1 pikë**

**Përgjigje:**

Tipi: Grykëderdhje në formë delte.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton tipin e saktë**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

- b) Argumentoni faktorët që ndikojnë në krijimin e saj.

**4 pikë**

- a) Argumenti: kur deti është i cekët, valët nuk kanë lartësi të madhe dhe kur maretë nuk kanë forcë të madhe sa të jenë në gjendje të heqin menjëherë depozitimet që sjell lumi. Në këtë mënyrë lumi ndahet në degëzime që hapin me vështirësi rrugën përmes materialeve të depozituara, duke formuar kështu grykëderdhjen në formë delte.

**Nxënësi fiton:**


**4 pikë nëse për shpjegimin e saktë sa më sipër**

**3 pikë nëse shkruan tre faktorët e formimit të deltës, pa bërë shpjegimin se si ndodh**

**2 pikë nëse dy faktorët e formimit të deltës, pa bërë shpjegimin se si ndodh**

**1 pikë nëse shkruan faktorët e formimit të deltës, pa bërë shpjegimin se si ndodh**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**




8. Ndërtoni profilin topografik të vijës së hequr AB në hartën topografike të dhënë.

**3 pikë**

- 3 pikë** nëse ndërton profilin e saktë  
**2 pikë** Nëse ndërton pingulet (projeksionet) dhe kodrën e parë  
**1 pikë** Nëse ndërton profilin e kodrës së parë **OSE** ndërton vetëm pingulet (projeksionet)  
**0 pikë** Nëse e ndërton profilin gabim ose nuk e ndërton fare

*Shënim: nëse nxënësi e ndërton profilin pa hequr pingulet nuk fiton asnjë pikë*



- 9.** Sa është koha lokale e Ankarasë me gjatësi gjeografike lindore  $33^{\circ}$ , kur në Tiranë me gjatësi gjeografike lindore  $20^{\circ}$ , koha lokale është  $13h05'$ .

**4 pikë**

Gjejmë sa është ndryshimi i gjatësisë midis gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës.

$$33^{\circ} - 20^{\circ} = 13^{\circ}$$

$$24 \text{ h} \longrightarrow 360^{\circ}$$

$$1 \text{ h} \longrightarrow 15'$$

$$X = 360 * 1 / 24 = 15^{\circ}$$

Toka për 1 orë ( $60'$ ) rrotullohet  $15^{\circ}$ , gjejmë sa minuta i duhen asaj për që të rrotullohet  $1^{\circ}$ .

$$60 \text{ min} \longrightarrow 15^{\circ}$$

$$X \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$X = 60 * 1 / 15 = 4 \text{ minuta}$$

Për 4min Toka rrotullohet  $1^{\circ}$ , gjejmë sa minuta i duhen asaj që të rrotullohet  $13^{\circ}$ .

Kështu:

$$\text{Për } 4 \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$\text{Për } X \text{ min} \longrightarrow 13^{\circ}$$

$$X = 13 * 4 / 1 = 52 \text{ min}$$

Pra ndryshimi midis kohës lokale të Ankarasë dhe Tiranës është 52min.

Koha lokale e Ankarasë është  $13h05' + 52' = 13h57'$

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse bën një zgjidhje të plotë të ushtrimit.

**OSE**

**3 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës; gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për  $1^{\circ}$  dhe gjen në minuta ndryshimin në grade të gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës

**2 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës, gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për  $1^{\circ}$

**1 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës.

**0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk e zgjidh fare